

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD NË EMËR TË POPULLIT
FERIZAJ I UROŠEVAC

31.07.2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm –

Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED], për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, sipas propozim akuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr. 2520-7/2016 të datës 18.04.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të prokurorit të shtetit Sebahate Sinanai, të akuzuarit, me datë 20.06.2017, shpall dhe publikisht komunikon këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari :

[REDACTED], me nofkën [REDACTED], nga babai [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] i lindur me [REDACTED], në Ferizaj, ku eshë jeton ne rrugën [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i papunësuar, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të mesme ekonomike, [REDACTED].

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë 23 nëntorë 2016, rreth orës 14.00 h, në rrugën ‘Rexhep Bislimi’ në Ferizaj, saktësisht në lokalit [REDACTED], i pandehuri pa autorizim ka poseduar substancë apo preparate të cilat të cilat me ligj janë shpallur si narkotikë, ashtu që me rastin e zbatimit të urdhëresës së lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj ndaj të pandehurit [REDACTED], gjatë kontrollit në lokalit e tij janë gjetur dhe sekuestruar 1.65 gram substancë narkotike e llojit marihuanë si dhe dy shishe ‘Metadon’ prej nga 10 mg,-

-me të cilën ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së

Andaj gjykata duke u bazuar ne dispozitat ligjore te neneve 4, 7, 17,41,43,46, 73, të KK-se dhe nenit 365 te KPPRK-se,

GJYKON

Me dënim me gjobë në lartësi prej 300 /treqind / € të cilin dënim është i obliguar ta paguaj ne afat prej 30 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Konform nenit 275 par.konfiskohet në mënyr të përhershme 1.65 gram substancë narkotike e llojit marihuanë si dhe dy shishe 'Metadon' prej nga 10 mg.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajnë shumën me nga 25 /njëzet e pesë/€ në afatin prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzë PP.II.nr. 2502-7/2016 të datës 18.04.2017 ka akuzuar [REDAKTUAR], për veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar me datën 13.06.2016 në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit Ismet Rrahmani, ka mbetur në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale, duke i propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptohet dënim i paraparë sipas ligjit.

kryerjen e veprave penale të natyrës së njëjtë me Aktgjykim të plotfuqishëm PKR. NR. 29/16 të datës 31.03.2016, po ashtu vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me dënimin e shqiptuar me gjobë, do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet ne dispozitat e nenit 41 të KPRK-së, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform nenit 275 par.konfiskohet në mënyr të përhershme 1.65 gram substancë narkotike e llojit marihuanë si dhe dy shishe 'Metadon' prej nga 10 mg.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 /njëzet e pesë /€ në afatin prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr. 907/17 me datë 20.06.2017

Zyrtare Ligjore

Ganimete Avdiu

Gjyqtarja Individuale,

Hakile ILAZI



Këshilla juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit Kosovës, në afat prej 15/pesëmbëdhjete/ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.